

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare “Maestro Figaro 1966” sh.p.k

Sot më datë 24.08.2023, unë e nënshkruara:

1. Muharrem Rada

me vullnetin tim të lirë dhe të plotë në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ hartoj këtë Akt Themelimi të Shoqërisë “Maestro Figaro 1966 “ sh.p.k, si më poshtë vijon:

1. FORMA LIGJORE

“Maestro Figaro 1966 “ sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

2. ORTAKU THEMELUES

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare është :

a. Muharrem Rada

3. OBJEKTI

Shoqëria do të krijohet me qëllim objekti kyesorë:

- Berber, Bar Kafe, Tabakino

4. SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë tregtare “Maestro Figaro 1966 “ SHPK do të jetë në adresën: Rruga “ Kavajës “ Tiranë, zona kadastrale 8220 me numër pasurie 6/265-N2.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të saj .

Shoqëria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj .

5. KOHËZGJATJA

Shoqëria krijohet për të vepruar për gjithë kohën e përcaktuar për sa kohë do ketë treg në shitjen e shërbimeve të saj.

6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “Maestro Figaro 1966 “ sh.p.k është 100.000 (njëqindmijë) lekë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

7. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME ORTAKËVE DHE PËRFAQËSUESI LIGJOR

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare “Maestro Figaro 1966 “ sh.p.k është edhe organi më i lartë i saj.

Përfaqësuesi ligjorë të shoqërisë do të jetë _ Muharrem Rada.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

8.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm i emëruar dhe i pandryshueshëm në përputhje me këtë statut për të gjithë kohëzgjatjen e shoqërisë.

8.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në çdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit

8.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

8.4 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat **3 vjeçar** për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së shoqërisë:

Znj. Muharrem Rada, shtetas shqiptar, e biri i Flamur, i datëlindjes 25.08.1990, lindur dhe banues në Fushë Krujë në lagjen Bakushe Visha, mbajtës i pasaportes me numër BE4770016 dhe numër personal J00825072Q, lëshuar nga Ministria e Brendshme datë 01.08.2022.

9. PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Prishja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë të parashikuar nga ligji, për çdo shkak tjetër të vendosur me vullnetin e ortakëve të shoqërisë.

10. TË NDRYSHME

Akti i themelimit të shoqërisë u përpilua në 2(dy) ekzemplarë, njëra për tu dorëzuar pranë organeve kompetente dhe tjetra do të mbetet në dosjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë “Maestro Figaro 1966” sh.p.k

Akti i themelimit të shoqërisë nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues .

ORTAKU THEMELUES

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Maestro Figaro 1966 “ Sh.p.k

